



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2097 prot.

Shkodër, më 30. 06 2023

DEKLARATË

Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", i mbledhur sot me datë 30.06.2023, bëri objekt të diskutimit ngjarjen e transmetuar në emisionin investigativ "Stop" të datës 21.06.2023 në TV Klan.

Senati Akademik distancohet nga veprimet individuale të paligjshme të cilitdo nga personeli akademik dhe joakademik, si dhe nga studentët të këtij universiteti.

Vërtetësia e pamjeve të paraqitura në emisionin investigativ shpresojmë të vlerësohet sa më parë nga organet kompetente, tek të cilat kemi besim.

Pasi të shprehen organet ligjzbatuese, kompetente, Senati Akademik do të jetë krejtësisht i qartë për mbajtjen e një qëndrimi përfundimtar dhe rrjedhimisht marrjen e masave që ligji dhe rregulloret e Universitetit të Shkodrës parashikojnë.

Senati Akademik kërkon nga të gjitha organet e tjera, pedagogët dhe studentët e Universitetit të Shkodrës, që të jenë të angazhuar për vijimin normal të aktivitetit të mbylljes së vitit akademik dhe të pranimeve të reja në programet tona të studimit.

KRYETARI

Prof.dr.Rajmonda Këcira